



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë/a: 25. 02. 2020

Ref: 034/2020

Për/Za/To: znj. Vjosa Osmani, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës

E nderuar znj. Kryetare,

Në nëntor të vitit të kaluar, një zyrtar i NATO-së më dorëzoi mua, në cilësinë time si kryeministër në ardhje i Republikës së Kosovës, një kopje të një marrëveshjeje ndërkombëtare të arritur në vitin 2013. Marrëveshja e ka formën e një shkëmbimi të letrave ndërmjet kryeministrit të atëhershëm, z. Hashim Thaçi, dhe sekretarit të përgjithshëm të atëhershëm të NATO-së, z. Anders Fogh Rasmussen. Përmes kësaj marrëveshjeje, kryeministri Thaçi, në emër të Republikës së Kosovës, barti te KFOR-i të drejtën absolute të vetos mbi të gjitha misionet e ardhshme të FSK-së në veri të Kosovës, për një periudhë të paafatizuar.

Ajo që menjëherë bie në sy, është se marrëveshja e mban datën 19 prill 2013, të njëjtën ditë kur u arrit e ashtuquajtura "Marrëveshja e Brukselit" (marrëveshja Kosovë-BE / BE-Serbi), e cila u publikua menjëherë brenda ditës dhe u ratifikua dy muaj më vonë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ajo që dëshmon letërshkëmbimi Thaçi-Rasmussen, pra, është fakti se ka jo vetëm një, por dy marrëveshje të Brukselit. Krahas marrëveshjes së publikuar dhe ratifikuar, ka pasur një tjetër marrëveshje, një marrëveshje sekrete dhe të paratifikuar, për të cilën z. Thaçi, për arsye ende të panjohura, nuk i ka informuar as deputetët e Kuvendit, as publikun e gjerë.

Pasi e pranova zyrtarisht detyrën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, i kërkova stafit të Zyrës së Kryeministrit që, pa vonesë, të analizojë përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje sekrete, si dhe implikimet e saj kushtetuese, përkatësisht në lidhje me kërkesat kushtetuese të përcaktuara me nenin 20 [Bartja e Sovranitetit], nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] dhe nenin 91 [Shkarkimi i Presidentit].

Qëllimi i kësaj shkrese është që t'ju njoftoj juve, në cilësinë tuaj si kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për ekzistencën e marrëveshjes sekrete, si dhe për rezultatet e analizës së Zyrës së Kryeministrit.

Për t'iu shmangur çdo keqkuptimi të mundshëm, dua të jem sa më i qartë: Unë, si kryeministër, nuk shpreh asnjë qëndrim për ose kundër marrëveshjes sekrete, për sa i përket përmbajtjes së saj. Unë, si kryeministër, e kuptoj dhe e vlerësoj thellësisht rëndësinë e jashtëzakonshme të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe NATO-s për sigurimin e plotë të integritetit territorial të Republikës dhe të qytetarëve të saj. Dhe unë, si kryeministër, i garantoj Kuvendit, si dhe të gjithë qytetarëve të Republikës, se nuk do të ndërmarr asnjë hap që do të rrezikonte këtë aleancë të domosdoshme për sigurinë e vendit tonë.

Mirëpo, kur presidenti i vendit, gjatë kohës kur ishte kryeministër, bart kompetenca sovrane të Republikës së Kosovës te një organizatë ndërkombëtare përmes një marrëveshjeje sekrete, pa e njoftuar Kuvendin dhe në shpërfillje të plotë të kërkesave të qarta të Kushtetutës, kjo është një gjendje që nuk mund ta toleroj, as si kryeministër, as si qytetar i Republikës së Kosovës.

E nderuar Kryetare, në fjalimin tuaj me rastin e 12-vjetorit të pavarësisë, ju keni bërë thirrje që "referencë e jona e çdoditshme të jetë Kushtetuta, ligjet dhe respekti ndaj tyre". Duke iu bashkuar thirrjes suaj, iu kërkoj të gjithë deputetëve të Kuvendit, të pozitës dhe të opozitës, që të trajtojnë këtë çështje me seriozitetin e duhur, jo si anëtarë të pozitës apo të opozitës, të një partie apo tjetër, por vetëm si mbrojtës të Republikës dhe të Kushtetutës, as më pak dhe as më shumë.

Për hir të korrektësisë, ju njoftoj se, në pamundësinë e presidentit për të gjetur kohën për t'u takuar pas zgjedhjes sime si kryeministër, ende s'kam pasur mundësi të ngre këtë çështje drejtpërsëdrejti me të. Sido që të jetë, shpresoj se do të kem mundësi të takohem me presidentin në një të ardhme të afërt. Ju siguroj se, në çdo rast, do t'ju mbaj ju, si dhe të gjithë deputetët e Kuvendit, vazhdimisht të informuar lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Albin Kurti
Kryeministër

Bashkëngjitur gjeni:

1. Shkëmbimi i letrave i datës 19 prill 2013, ndërmjet kryeministrit të atëhershëm të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dhe sekretarit të përgjithshëm të atëhershëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, z. Anders Fogh Rasmussen.
2. Opinioni juridik i Zyrës së Kryeministrit.

Kopje: z. Hashim Thaçi, president i Republikës së Kosovës
z. Aleksandër Lumezi, kryeprokuror i Shtetit i Republikës së Kosovës